



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 10634 Prot

Fier, me 18 . 09 .2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 87 ,Datë 18 . 09 .2025

“Për miratimin e krijimit të Njesisë Shpenzuese dhe ndryshimin e emërimit të disa Njësive Shpenzuese të Bashkisë Fier”

Në mbështetje të:

- Ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 23, pikat 7 , neni 33, pikat a) dhe b); neni 54, pika d);Ligjit nr. 9220, datë 15.04.2004 “Për shërbimin publik të varrimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 80/2014;Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 29.10.2014, “Për miratimin e Rregullores për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me VKM nr. 402, datë 05.07.2023;Ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 131, datë 26.11.2024 “Mbi strukturën, nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 139, datë 23.12.2024 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (2025-2027) dhe miratimin e buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2025”, i ndryshuar;

Gjithashtu:

Në funksion të riorganizimit të shërbimeve publike dhe përmirësimit të menaxhimit të burimeve financiare, njerëzore dhe infrastrukturore, Bashkia Fier:

PROPOZON:

- I. **Të miratohet krijimi i një njësie të re shpenzuese: “Ndërmarrja e Varrezave Publike ”**, e cila do të funksionojë si një strukturë më vete në varësi të Bashkisë Fier.
 1. Ndërmarrja ka për qëllim administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e të gjitha hapësirave të varrezave publike në territorin e Bashkisë Fier, si dhe ofrimin e shërbimeve funerale për qytetarët, kundrejt tarifave vendore të miratuara në paketë fiskale.
 2. Funksionet e saj përfshijnë: Rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike;Garantimin dhe organizimin e shërbimit publik të varrimit, në përputhje me ligjet ne fuqi.
 3. Numri fillestar i punonjësve të kësaj ndërmarrjeje miratohet në 50 (pesëdhjetë), bazuar në analizën e nevojave për funksionimin efikas të njësisë.
 4. Ndërmarrja do të financohet nga Buxheti i Bashkisë Fier .

Specializojë ndërmarrjet publike sipas fushave të veprimit për të përmirësuar eficiencën dhe cilësinë e shërbimeve;
Rrisë transparencën financiare dhe administrative, duke e bërë më të lehtë planifikimin dhe kontrollin e buxheteve sipas destinacionit të shpenzimeve;
Shmangë mbingarkesën e strukturave me funksione të shumëfishta që kërkojnë ekspertizë dhe mjete të ndryshme;

Përqendrojë Ndërmarrjen e Gjellbërimit tek misioni i saj themelor: përmirësimi i mjedisit urban përmes mirëmbajtjes së gjellbërimit dhe hapësirave publike rekreative.

Riorganizimi i propozuar nuk përfaqëson një reduktim të shërbimeve, por një ristrukturim funksional dhe modernizim të organizimit të ndërmarrjeve publike të Bashkisë Fier, në përputhje me parimet e mirëqeverisjes lokale, decentralizimit dhe përmirësimit të cilësisë së jetës në qytet.

Rekomandohet miratimi i këtij ndryshimi në strukturë dhe funksione, si pjesë e politikave të zhvillimit urban dhe përmirësimit të performancës së njësive të shërbimit publik vendor.

Për Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit

Drejtori Pranvera Cina

Për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore

Drejtori Rozeta Memo

Për Drejtorinë Juridike

Drejtori Esmeralda Kapllanaj

KRYETAR
Armando Subashi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

Zv/Kryetar
Suela Prifti

